



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 41/2020 regjistër (JR)
Datë 21.09.2020

Nr. 32 i vendimit
Datë 23.11.2020

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më 23.11.2020, ditën e hënë, në orën 12:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Branko Hrvatit, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Petraq Dhimitri, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.

OBJEKTI: Shqyrtim i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 271, datë 06.07.2020.

BAZA LIGJORE: Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili ka kërkuar përfundimisht ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 271, datë 06.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me pikën e 2-të të dispozitivit të këtij vendimi, i cili përcakton humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i

Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, duke kërkuar mosaplikimin e këtij kufizimi, dëgjoji gjyqtaren relatores Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Petraq Dhimitri, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179, germa “b” e Kushtetutës, ishte gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe, për rrjedhojë, në zbatim të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex-officio*, duke u shortuar si subjekt rivlerësimi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në shortin e hedhur më datë 12.11.2019¹, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) i ka përcjellë² Komisionit më datë 24.01.2020 vendimin e tij nr. 36, datë 23.01.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit të gjyqtarit të gjykatës së Apelit Durrës, Petraq Dhimitri, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”.
3. Komisioni, më datë 30.06.2020, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit nëpërmjet adresës elektronike {***} se pranë tij është depozituar vendimi i KLGj-së për përfundimin e statusit të tij të magjistratit, për shkak të dorëheqjes nga detyra. Në këtë *e-mail*, Komisioni e njofton subjektin se, në bazë të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, gëzon të drejtën për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore publike, duke e informuar njëkohësisht se, nëse nuk e ushtron këtë të drejtë, procesi i tij i rivlerësimit do të ndërpritet pa u zhvilluar një seancë e tillë.
4. Po më datë 30.06.2020, subjekti i rivlerësimit i përgjigjet Komisionit se ai nuk është vënë asnjëherë në dijeni për përbërjen e trupit gjykues të Komisionit, i cili ka filluar procedurën e tij të rivlerësimit më 12.11.2019. Lidhur me kërkesën e Komisionit për zhvillimin e seancës dëgjimore, në zbatim të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, subjekti në këtë *e-mail* është shprehur: [...] *konfirmoj vullnetin tim për të mos ushtruar të drejtën për t’u dëgjuar nga Komisioni në seancë dëgjimore.*
5. Në rrethanat e mësipërme, Komisioni ndërpreu procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit Petraq Dhimitri, me vendimin nr. 271, datë 06.07.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 271, datë 06.07.2020, ka vendosur:
 1. *Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Petraq Dhimitri, është ndërprerë.*
 2. *Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*

¹ Komisioni në faqen e tij zyrtare në internet, <https://kpk.al/njoftim-143/>, në rubrikën “njoftime”, më datë 13.11.2019, ka publikuar “Njoftim për shortin e datës 12.11.2019”, duke u shprehur:

“Në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 8 të nenit 3 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, pas miratimit të listës me vendimin nr. 59 të datës 07.11.2019 të Komisionit, më 12 nëntor 2019 janë shortuar dhe kanë filluar procedurat e rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit, si më poshtë: [...]”

Në këtë listë, me nr. rendor 45, figuron emri i subjektit të rivlerësimit Petraq Dhimitri (Koço) - Gjykata e Apelit Durrës.

² Protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 24.01.2020.

III. Shkaqet e ankimit

7. Subjekti i rivlerësimit Petraq Dhimitri, më datë 12.08.2020, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 271, datë 06.07.2020, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur sa më poshtë vijon.

7.1 *Lidhur me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor*, subjekti pretendon se Komisioni ka dështuar në përmbushjen e kërkesave të nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me njoftimin e subjektit për fillimin e procedurës së rivlerësimit dhe veprimet e ndërmarra nga Komisioni për këtë qëllim. Mosnjoftimin e tij për fillimin e procedurës së rivlerësimit dhe mosinformimin për veprimet e tjera të Komisionit, subjekti e konsideron shkelje të nenit 47 të Kodit të Procedurës Administrative tek i cili referon neni 47 i ligjit nr. 84/2016, duke pretenduar se nuk i është dhënë mundësia për t'u shprehur në lidhje me aspekte ligjore të çështjes së rivlerësimit që lidhen kryesisht me pezullimin e kësaj procedure deri në përfundimin e çështjes penale në gjykim e sipër të nisur ndaj tij, rezultati i së cilës kushtëzon qartazi rezultatin e rivlerësimit *ex-officio* nga ana e Komisionit.

7.2 *Lidhur me themelin e çështjes*, subjekti i rivlerësimit pretendon se nga ana e Komisionit është zbatuar në mënyrë të ngurtë (*strictu sensu*), parashikimi kushtetues i pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, duke parashtruar se Kolegji ka detyrimin për interpretimin shterues të kësaj norme kushtetuese në lidhje me rrethin e subjekteve për të cilët vlen përcaktimi i ndalimit 15-vjeçar për emërimin si gjyqtar e prokuror i çdo niveli.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. *Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

a) *Juridiksioni i Kolegjit*

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Petraq Dhimitri dhe për të cilin subjekti i rivlerësimit nëpërmjet ankimit kërkon ndryshimin e tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh³, nga data

³ Ankimi i subjektit të rivlerësimit është depozituar fillimisht pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit më datë 12.08.2020 dhe nga ky institucion, bazuar në përcaktimin e nenit 63 të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i është përcjellë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me shkresën nr. {***}, datë 13.08.2020, e cila i është drejtuar njëkohësisht edhe subjektit të rivlerësimit.

Trupa gjyquese e Komisionit, me vendimin nr. 271/1, datë 31.08.2020, ka vendosur të pranojë ankimin e subjektit Petraq Dhimitri, duke e konsideruar se plotëson kushtet e nenit 63 të ligjit nr. 84/2016 si ankim të plotë dhe në

e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit.

10. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”) për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Lidhur me çështjen objekt gjykimi, e cila i përket shqyrtimit të ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 271, datë 06.07.2020, Kolegji vlerësoi se nuk gjendej para asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, pasi së pari, subjekti me ankimin e tij nuk ka paraqitur asnjë provë të re, sipas pikës “a” të kësaj dispozite; dhe së dyti, nga shqyrtimi i akteve të administruara në fashikullin e krijuar nga Komisioni, rezulton se prej këtij të fundit, më datë 30.06.2020, nëpërmjet komunikimit në adresën e tij elektronike {***}, subjekti është njoftuar lidhur me statusin aktual të procesit të tij të rivlerësimit, duke iu komunikuar aktet kryesore të administruara përgjatë procesit të rivlerësimit, si dhe duke e bërë me dije për të drejtën që ai gëzon për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore publike. Në përgjigje të këtij njoftimi, subjekti, më datë 30.06.2020, ka kthyer përgjigje duke konfirmuar dijeninë për procesin dhe duke deklaruar vullnetin e tij se nuk dëshiron të marrë pjesë në seancë dëgjimore.
11. Në këto kushte, Kolegji konstaton se përfundimi i procesit të rivlerësimit në Komision për subjektin Petraq Dhimiri, pa një seancë dëgjimore, nuk është rrjedhojë e një shkeljeje të rëndë procedurale në kuptim të nenit 51, germa “b” e ligjit nr. 49/2019, por rezultat i vullnetit të shprehur të subjektit të rivlerësimit, i cili në mënyrë të qartë ka refuzuar duke hequr dorë nga e drejta për t’u dëgjuar me vullnet të lirë dhe pa ekuivok në seancën dëgjimore për procesin e tij të rivlerësimit. Në këto kushte, Kolegji vlerësoi se çështja mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet e fashikullit të administruara nga Komisioni përgjatë fazës së procesit administrativ që lidhet me rivlerësimin kalimtar të këtij subjekti, dhe vendosi të gjykojë këtë çështje në dhomë këshillimi, konform rregullit të përcaktuar në nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 dhe në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit

11.1 Lidhur me shkakun e ankimit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka dështuar në përmbushjen e kërkesave të nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me njoftimin e subjektit për fillimin e procedurës së rivlerësimit dhe veprimet e ndërmarra nga Komisioni për këtë qëllim janë në shkelje të nenit 47 të Kodit të Procedurës Administrative, tek i cili referon neni 47 i ligjit nr. 84/2016. Në vijim të këtij shkakut ankimi, subjekti pretendon se nuk i është dhënë mundësia nga Komisioni për t’u shprehur në lidhje me aspekte ligjore të çështjes së rivlerësimit që lidhen kryesisht me pezullimin e kësaj procedure deri

përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative .

*Vendimi i Komisionit nr. 271/1, datë 31.08.2020, “Për pranimin e ankimit”, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit Petraq Dhimiri, me shkresën nr. {***} prot., datë 31.08.2020, nëpërmjet shërbimit postar, për të cilën subjekti ka nënshkruar dëftesën e komunikimit postar për marrjen e saj më datë 08.09.2020 .*

në përfundimin e çështjes penale (në gjykim e sipër) të nisur ndaj tij, rezultati i së cilës kushtëzoi qartazi rezultatin e rivlerësimit *ex-officio* nga ana e Komisionit.

11.2 Nga analiza që u krye në Kolegj për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi të subjektit, rezultoi se për këtë subjekt, veprimtaria procedurale ka nisur me shortin e datës 12.11.2019, i cili ka përcaktuar trupin gjykues të Komisionit dhe rolin përkatës të secilit prej anëtarëve të tij. Hedhja e shortit, si një veprim procedural që shënon momentin fillestar të veprimtarisë procedurale të Komisionit për subjektet e këtij procesi, është bërë e ditur nga Komisioni nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare⁴ të këtij hapi procedural dhe listës së subjekteve të shortuar. Kjo e dhënë lehtësisht e aksesueshme dhe e konstatueshme në një platformë të lirë (*open data*) të një institucioni si Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, u jep subjekteve të rivlerësimit të drejtën që në çdo moment të mund të kërkojnë të dhëna mbi fazën e procesit të tyre të rivlerësimit.

11.3 Në vijim të procedurës administrative të zhvilluar në Komision në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit, rezulton se Komisioni ka komunikuar me subjektin e rivlerësimit sipas hapave të përshkruar më poshtë.

i. Me *e-mail*-in e datës 25.06.2020, dërguar nga një prej adresave elektronike të Komisionit, {***}, në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit Petraq Dhimitri, {***}, është informuar subjekti (i) për shortin e hedhur më 12.11.2019 dhe fillimin e procedurës së rivlerësimit të tij; (ii) për ndryshimin e relatorit të çështjes dhe për vendimin nr. 36 të KLGJ-së për mbarimin e statusit të tij të magjistratit. Nëpërmjet kësaj *e-mail*-i, subjekti informohet gjithashtu nga Komisioni se ka të drejtën që, në zbatim të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, të dëgjohet në seancë dëgjimore dhe se nëse nuk e ushtron këtë të drejtë, procesi i tij i rivlerësimit do të ndërpritet pa zhvilluar seancë dëgjimore.

ii. Bashkëlidhur këtij *e-mail*-i gjendet e administruar edhe përgjigjja automatike e marrë nga sistemi, se njoftimi te pritësi i këtij *e-mail*-i është përmbushur, por nuk ka njoftim marrjeje nga serveri i adresës {***}.

iii. Më datë 30.06.2020, nga adresa elektronike e Komisionit {***}, i është dërguar subjektit të rivlerësimit një *e-mail* tjetër me të njëjtin tekst si ai i mëparshmi, në adresën tjetër elektronike të tij: {***}.

11.4 Duke analizuar sa më sipër, në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni ka “dështuar” të përmbushë kriteret e nenit 46⁵ të ligjit nr. 84/2016, Kolegji konstaton se ky pretendim është i pavërtetë. Nga praktika e përcjellë Komisionit prej ILDKPKI-së, rezulton se ndryshe nga sa subjekti Petraq Dhimitri pretendon në ankim, prej tij në deklaratën *vetting*⁶, si adresë elektronike për efekt komunikimi lidhur me procesin kalimtar të rivlerësimit, është deklaruar adresa e *e-mail*-it {***}.

11.5 Kjo e dhënë e konstatuar në deklaratën *vetting*, përveçse e bën jo të vërtetë pretendimin e subjektit në ankim se prej tij nuk është deklaruar adresë *e-mail*-i në deklaratën e pasurisë dhe se ai nuk disponon asnjë adresë tjetër përveç asaj {***} (e cila i është bërë e ditur Komisionit së fundi, pas përpjekjeve për të komunikuar me subjektin e rivlerësimit), nga ana tjetër, gjithashtu konfirmon se

⁴ Shih poshtëshënimin nr. 1.

⁵ Neni 46, “Njoftimi”, i ligjit nr. 84/2016, përcakton:

“1. Njoftimi dhe çdo komunikim gjatë procesit të rivlerësimit bëhet në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1, të këtij ligji.

2. Nëse subjekti i rivlerësimit është me leje të zakonshme ose me leje lindjeje, njoftimi bëhet në adresën elektronike private që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1, të këtij ligji.

3. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë dhe është i detyruar të aksesojë e të përdorë adresën elektronike zyrtare gjatë procesit të rivlerësimit.

4. Në rast se njoftimi nuk realizohet sipas parashikimeve të mësipërme, mund të përdoren forma të tjera të komunikimit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative”.

⁶ Deklarata sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016.

veprimet e Komisionit [të shpjeguara më sipër në paragrafët 11.3 dhe 11.4] për kontaktimin e tij nëpërmjet adresës elektronike (***), e cila ishte adresa e deklaruar në deklaratën *vetting*, janë kryer në përputhje me ligjin. Në analizë të këtyre të dhënave, mosaksesimi prej subjektit në adresën elektronike të deklaruar në deklaratën *vetting* të cilën, më pas e mohon se e ka deklaruar, nuk ngarkon me përgjegjësi Komisionin për mosnjoftimin e tij dhe as përfaqëson veprimtari të Komisionit në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 84/2016, duke provuar se të drejtat e subjektit të rivlerësimit, në kuadër të procesit të rregullt ligjor, nuk janë cenuar përgjatë këtij procesi.

11.6 Lidhur me elementin tjetër të këtij shkak ankimi, se mosnjoftimi i subjektit nga Komisioni për fillimin e procesit të rivlerësimit, për përbërjen e trupit gjykues dhe për aktet e administruara, është në shkellje të nenit 47 të Kodit të Procedurës Administrative, i cili referon në nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, dhe se i kanë mohuar subjektit mundësinë për t'u shprehur në lidhje me aspekte ligjore të çështjes së tij të rivlerësimit, kryesisht me pezullimin e kësaj procedure deri në përfundimin e çështjes penale në ngarkim të tij, rezultati i së cilës kushtëzon qartazi rezultatin e rivlerësimit kalimtar, Kolegji vlerëson se:

11.7 *Së pari*, duke iu referuar vendimit të Komisionit nr. 271, datë 06.07.2019, konstatohet në mënyrë të qartë se prej Komisionit është vendosur ndërprerja e procesit të rivlerësimit për subjektin Petraq Dhimitri për shkak të dorëheqjes së tij nga statusi i magjistratit, të miratuar me vendimin nr. 36, datë 23.01.2020, të KLGj-së. Në këtë mënyrë, është evidente se vendimmarrja e Komisionit nuk ka ardhur si pasojë e procedurave rivlerësuese të Komisionit në drejtim të kontrollit të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të subjektit, procedurë e cila natyrshëm do të kërkonte përfshirjen e subjektit nëpërmjet shpjegimeve e paraqitjes së provave të nevojshme për të zgjidhur dhe mbajtur një qëndrim për thelbin e çështjes. Nga natyra e vendimit të marrë nga Komisioni, konstatohet lehtësisht se ai nuk është përfshirë dhe nuk ka marrë qëndrim në lidhje me kriteret e procesit të rivlerësimit, për pasojë ndërveprimi i subjektit, i munguar sipas tij, nuk do t'i shërbente në këtë rast arritjes së një vendimi prej organit, për sa kohë që vetë procesi është ndërprerë sipas parashikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, që do të thotë se është ndërprerë çdo aktivitet procedural i Komisionit drejt zhvillimit të procedurës së rivlerësimit.

11.8 *Së dyti*, Kolegji vëren se, edhe nëse pranojmë që Komisioni ka dështuar në njoftimin e subjektit për fillimin e procedurës së rivlerësimit, mbi përbërjen e trupës gjykuese dhe të akteve të mbledhura përgjatë hetimit, në kuptim të nenit 47⁷ të Kodit të Procedurave Administrative, nuk rezulton të jetë cenuar asnjë e drejtë e subjektit, për sa kohë të dhënat e mbledhura nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ nuk kanë shërbyer për asnjë moment për vendimmarrjen për procesin e tij të rivlerësimit. Gjithashtu, në analizë të situatës faktike, Kolegji konsideron faktin se komunikimi i Komisionit me subjektin ka “dështuar” të kryhet sipas pretendimit të tij, pasi Komisioni e ka njoftuar/kontaktuar atë në një adresë elektronike që ai pretendon se nuk e ka deklaruar në deklaratën *vetting*, kur në të vërtetë nga leximi i kësaj deklarate rezulton se Komisioni ka përdorur për komunikim pikërisht këtë adresë të deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit (*shih paragrafët 11.3 dhe 11.4 më sipër*). Komunikimi i mësipërm rezulton të jetë kryer prej Komisionit në zbatim të përcaktimeve të nenit 46, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave ai bëhet në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1 e këtij ligji. Për më tepër, sipas parashikimit të nenit 46, pika 3 e ligjit, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë dhe është i detyruar të aksesojë e të përdorë adresën elektronike zyrtare gjatë procesit të rivlerësimit. Në një vlerësim tërësor të kësaj situatë faktike, e gjithë kjo sjellje e subjektit dhe pretendimet e tij për një mungesë komunikimi të Komisionit me të, përgjatë procesit

⁷ Në nenin 47, “E drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime”, të Kodit të Procedurës Administrative, përcaktohet: “Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes”.

të rivlerësimit jo vetëm që nuk kanë prodhuar shkeljen e ndonjë të drejte të subjektit, por duket se demonstronjë një përpjekje të subjektit për t'u shmangur përgjegjësi të tij në raport me procesin duke vështirësuar komunikimin e Komisionit me të në kundërshtim me detyrimin e tij ligjor për bashkëpunim, parashikuar në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

11.9 Në vijim të analizimit të këtij pretendimi të subjektit në kuptim të cenimit të parimeve të procesit të rregullt ligjor, si: e drejta për t'u mbrojtur, për t'u dëgjuar, parimi i kontradiktorialitetit e i barazisë së armëve, nga të dhënat e akteve të administruara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, rezulton se nuk ka munguar tërësisht komunikimi i subjektit me Komisionin, pasi ndërmjet tyre, më datë 30.06.2020, ka pasur një komunikim me *e-mail*⁸ të dokumentuar nga sistemi elektronik i komunikimit. Nga përmbajtja e këtij komunikimi, rezulton se Komisioni me *e-mail*-in e datës 30.06.2020, pasi ka konstatuar se prej subjektit nuk është aksesuar adresa elektronike e deklaruar prej tij në deklaratën *vetting*, e ka informuar atë në adresën tjetër elektronike të konfirmuar me anë të komunikimit telefonik prej vetë subjektit, lidhur me zhvillimet e procesit të tij të rivlerësimit. Nga ky komunikim me Komisionin, kuptohet se përpara marrjes së vendimit, subjekti është informuar në mënyrë të përmbledhur për të gjitha fazat e procedurës administrative të ndjekur për procesin e tij të rivlerësimit, siç janë: përbërja e trupës gjyqësore, ndryshimi i komisioneres relatores, administrimi i vendimit i Këshillit të Lartë Gjyqësor për pranimin e dorëheqjes së tij nga detyra. Në këtë *e-mail*, atij gjithashtu i është bërë e ditur e drejta e tij për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore publike dhe madje edhe vendimmarrja e pritshme për t'u marrë në rrethanat faktike në të cilat gjendej procedimi. Në përgjigje të këtij *e-mail*-i, subjekti rezulton se ka zgjedhur të refuzojë ushtrimin e kësaj të drejte, duke presupozuar se ka qenë në dijeni të plotë të konsekuencës ligjore që vinte pas këtij veprimi.

11.10 Bazuar në sa arsyetuar më sipër, Kolegji i konsideron si të pambështetura në fakte dhe ligj pretendimet e subjektit të rivlerësimit për cenim prej Komisionit të parimeve të procesit të rregullt ligjor në këndvështrim të kërkesave të nenit 6 të KEDNj-së dhe të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

12. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka zbatuar në mënyrë të ngurtë (*strictu sensu*) parashikimin kushtetues të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës, dhe se Kolegji ka detyrimin për interpretimin shterues të kësaj dispozite kushtetuese për sa i përket rrethit të subjekteve për të cilët vlen përcaktimi i ndalimit 15-vjeçar për emërimin si gjyqtar e prokuror i çdo niveli, Kolegji, pasi analizoi situatën faktike në raport me parashikimin ligjor respektiv, arriti në konkluzionin se ky pretendim nuk është i bazuar ligjërisht.

12.1 Në funksion të shqyrtimit të këtij pretendimi, Kolegji konstaton se çështjet e ngritura në ankim, të cilat përbëjnë thelbin e këtij pretendimi, renditen si në vijim: *i)* dorëheqja nga funksioni i magjistratit prej subjektit është kryer kur ende nga Komisioni nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim administrativ për rivlerësimin e tij mbi bazën e tri kriterëve; *ii)* nëse motivet e dorëheqjes së tij nga detyra duhet të konsiderohen para marrjes së vendimit nga Komisioni, sepse jo çdo dorëheqje bëhet për qëllim të shmangies nga procesi i rivlerësimit; *iii)* subjekti i rivlerësimit nuk mund të konsiderohet gjyqtar efektiv (*ratione materiae*) përderisa përmes vendimit të datës 09.02.2018 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ishte pezulluar nga detyra për shkak të një procesi penal në ngarkim të tij, të iniciuar nga ish-Prokuroria e Krimeve të Rënda, i cili është në proces gjykimi, pa një vendim përfundimtar të formës së prerë.

12.2 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se koha në të cilën ai ka dhënë dorëheqjen nga detyra e gjyqtarit, ka përkuar me një fazë të procesit të rivlerësimit në të cilën nuk ishin

⁸ Më datë 30.06.2020, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur *e-mail*-it të Komisionit nga adresa tjetër elektronike e tij: {***}

ndërmarrë hapa proceduralë në lidhje me procesin, për pasojë ajo nuk duhet të ndikonte në vendimmarrje, konsiderohet prej Kolegjit si jorelevante për zgjidhjen e çështjes. Pavarësisht momentit në të cilin magjistrati zgjedh të japë dorëheqjen në raport me fazën në të cilën ndodhet procesi i rivlerësimit, i cili, në kuptim të neni 4, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka filluar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk ka përfunduar ende, me paraqitjen e dorëheqjes dhe deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, ky proces nuk mund të vazhdojë dhe duhet të ndërpritet. Këtë qëndrim thekson edhe Gjykata Kushtetuese në arsyetimin e vendimit të dhënë prej saj me nr. 78, datë 12.12.2017, sipas të cilit subjektet e rivlerësimit mund të japin dorëheqjen nga detyra, kur procesi i tyre i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, dhe në këto raste procesi i rivlerësimit ndërpritet.

12.3 Për pasojë, në analizë të kësaj situate faktike, Kolegji e gjen të drejtë reagimin e Komisionit, i cili pavarësisht se ndodhet në një stad të hershëm procedural në raport me procesin e rivlerësimit të subjektit, ka ndërmarrë hapa që kanë konkluduar me ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin, të materializuar në vendimin objekt gjykimi. Kolegji, ashtu si edhe Komisioni, vlerëson se momenti i pranimit të dorëheqjes nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe deklarimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i mbarimit të statusit të magjistratit për të, vendim i cili nuk është ankimuar prej subjektit, i marrë në zbatim të nenit 64, germa “a” e ligjit nr. 96/2016, shkakton humbjen e kësaj cilësie të domosdoshme për të vazhduar procesin e rivlerësimit, duke qenë se pas këtij momenti, subjekti nuk bën më pjesë te kategoria e personave që parashikon neni 179/b, pikat 3 e 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, se duhet t’i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, të cilët konsiderohen si subjekte të rivlerësimit sipas parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.

12.4 Lidhur me pretendimin e subjektit se duhet të konsiderohen motivet personale që shtyjnë subjektin e rivlerësimit drejt aktit të dorëheqjes para marrjes së një vendimi si ky objekt gjykimi, Kolegji çmon se është një pretendim i paarsyeshëm dhe i pambështetur në ligj. Lidhur me këtë çështje, Kolegji vlerëson të analizojë parashikimin e nenit 65, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: *Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar [...].* Në këndvështrim të këtij parashikimi ligjor, kuptohet qartë se ligjvënësi ka dashur të zhveshë organin përkatës, në këtë rast KLGj-në, nga vlerësimi apo analizimi i arsyeve apo motiveve të magjistratit kur ai zgjedh të dorëhiqet nga detyra, duke e konsideruar këtë veprim të tij si një akt krejtësisht të njëanshëm dhe një të drejtë natyrale të çdo individi. Për sa kohë që ligji nuk njeh këtë kompetencë apo detyrim, që të vlerësojë e analizojnë arsyet e dorëheqjes për organin që e merr atë drejtpërdrejt në shqyrtim, aq më pak këto motive mund të kenë peshë apo të afektojnë vendimmarrjet e organeve të rivlerësimit, të cilat administrojnë jo drejtpërdrejt dorëheqjen si një akt të subjektit, por vendimin e këshillit respektiv që, për këtë arsye, deklaron mbarimin e statusit të magjistratit. Në këtë mënyrë, pretendimi i ngritur se motivet e dorëheqjes duhet të kenë rëndësinë e tyre në vlerësimin që i bëhet këtij akti në raport me procesin e rivlerësimit, për më tepër pa përcaktuar as pasojën konkrete që pretendohet që këto motive të kenë, konsiderohet nga Kolegji i pambështetur dhe i padrejtë.

12.5 Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit se në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit nga Komisioni, ai nuk ka qenë gjyqtar efektiv (*rationae materiae*), pasi me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), të datës 09.02.2018, është pezulluar nga detyra për shkak të një procesi penal të regjistruar nga ish-Prokuroria e Krimeve të Rënda, Kolegji në analizë të parashikimeve ligjore të zbatueshme, konkludon se është një pretendim i pambështetur në ligj.

12.6 Në këndvështrim të fakteve të deklaruara prej subjektit, Kolegji konstaton se masa e pezullimit të subjektit të rivlerësimit nga ushtrimi i funksioneve të gjyqtarit është vendosur prej

KLD-së, në zbatim të nenit 140, pika 3, germa “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e nenit 151, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, pezullimi nga detyra i subjektit është vendosur si një masë e përkohshme e detyrueshme nga Kushtetuta e ligji deri në përfundimin e procesit penal që zhvillohet ndaj tij. Vendosja e kësaj mase pezulluese zbatohet në praktikë me ndalimin e ushtrimit të funksioneve të gjyqtarit përgjatë kohës që masa është në fuqi dhe me disa kufizime të tjera të natyrës financiare⁹, por ajo nuk e zhvesh magjistratin nga statusi i tij dhe nga të gjitha detyrimet që burojnë për shkak të këtij statusi, një ndër të cilat është edhe nënshtrimi ndaj procesit të rivlerësimit kalimtar.

12.7 Në këtë kuptim, pretendimi se subjekti nuk duhet të ishte nën juridiksionin e Komisionit, për sa kohë që ai ishte i pezulluar nga detyra, por që gëzonte statusin e magjistratit, mbetet një pretendim që nuk ka mbështetje ligjore, për sa kohë që kushti që cilëson magjistratin si subjekt rivlerësimi, është pasja e statusit të magjistratit, status të cilin ai e gëzonte deri në deklarimin e mbarimit të tij me vendimin përkatës të KLGj-së.

12.8 Në përfundim të analizës së mësipërme, Kolegji arrin në përfundimin se Komisioni me të drejtë ka vendosur të ndërpresë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Petraq Dhimitri, për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit, si pasojë e dorëheqjes së tij dhe se çdo argument i parashtruar e pretenduar prej subjektit në këtë ankim nuk delegjtitimon këtë qëndrim.

12.9 Në vijim të këtij konkluzioni, Kolegji, në zbatim edhe të jurisprudencës së tij të konsoliduar tashmë¹⁰, vlerëson se zbatimi i nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, është pasojë ligjore e drejtpërdrejtë e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit për shkaqet e mësipërme, të shpallura nga Kushtetuta për të gjithë ata subjekte rivlerësimi, të cilët me vullnetin e tyre nuk i nënshtrohen këtij procesi që synon verifikimin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive të tyre profesionale, në funksion të qëllimit të kthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

12.10 Në këto kushte, as Komisioni dhe as Kolegji nuk kanë një kompetencë diskreacionale për të vlerësuar ose jo aplikimin e ndalimit që parashikon neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, përveç se të deklarojnë ndalimin e parashikuar në këtë dispozitë që përcakton humbjen e së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t’u emëruar si gjyqtar apo prokuror i çdo niveli, anëtar i këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë apo Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë prej 15 vitesh.

13. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Kolegji e gjen të drejtë vendimin e Komisionit dhe çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pasi dorëheqja e tij nga detyra ka sjellë si efekt ligjor ndërprerjen e procesit të rivlerësimit e, për pasojë, humbjen e së drejtës për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i

⁹ Në nenin 151 të ligjit nr. 96/2016, të titulluar “Pezullimi i detyruar”, përcaktohet:

“1. Magjistrati pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit përkatës kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje. [...]”

Në nenin 157 të ligjit nr. 96/2016, të titulluar “Pezullimi i pagës dhe përfitimeve të tjera”, përcaktohet:

“1. Magjistrati përfiton pagë të plotë gjatë pezullimit, përveç kur parashikohet ndryshe nga përcaktimet e pikave të mëposhtme të këtij neni.

2. Nëse magjistrati dënohet për kryerjen e një vepre penale nga gjykata e shkallës së parë ose jepet masë disiplinore për një shkelje disiplinore nga Këshilli kompetent, Këshilli mund të pezullojë përfitimin e pagës deri në 50 për qind, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit, derisa të vendoset mbi çdo ankim të paraqitur në gjykatën më të lartë.

3. Nëse vendimi i dhënë nga gjykata më e lartë është në favor të magjistratit, çdo shumë e mbajtur, sipas pikës 2 të këtij neni, i kthehet menjëherë magjistratit. [...]”

¹⁰ Shih vendimet e Kolegjit nr. 1/2018 (JR), datë 11.06.2018; nr. 5/2018 (JR), datë 10.09.2018; nr. 18/2020 (JR), datë 29.07.2020.

Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare. Për këtë arsye, Kolegji e gjen të drejtë përcaktimin e pikës 2 të vendimit të Komisionit nr. 271, datë 06.07.2020.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 271, datë 06.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Petraq Dhimitri.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 23.11.2020.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi